

Treguesit e Mediave 2015

Studim i thukët nga këndvështrimi i gazetarëve mbi lirinë dhe kushtet e mediave në Kosovë



Tabela e Përmbajtjes

1.	Hyrja.....	6
	Historiku.....	6
2.	Metodologjia.....	8
	2.1 Madhësia e mostrës.....	8
	2.2 Kufizimet	9
3.	Përmbledhje Ekzekutive	10
	Gjetjet kryesore	10
4.	Rezultatet.....	14
	4.1 Perspektiva legale dhe zbatueshmëria e lirisë së shprehjes dhe informacionit	14
	4.2 Mekanizmat vetërregullues të mediave	22
	4.3 Anshmëria e mediave dhe profesionalizmi.....	25
	4.4 Transparenca e Institucioneve në lidhje me media	29
	4.5 Ndërhyrja në media	33
	4.6 Siguria në gazetari.....	45
5.	Përmbyllje	50
	Aneksi. Pyetëtori i hulumtimit	51

Lista e Figurave

Figura 1. Sipas jush, a garantohet liria e shprehjes me legjislacionin (Kushtetutën) e Kosovës.....	14
Figura 2. Sipas jush, a garantohet liria e shprehjes me legjislacionin (Kushtetutën) e Kosovës? Përgjigje “Po, plotësisht”. Tabelim i kryqëzuar me llojet e mediave	15
Figura 3. Sipas jush, a garantohet liria e shprehjes me legjislacionin (Kushtetutën) e Kosovës? Përgjigje të kombinuara. Tabelim i kryqëzuar bazuar në etnicitet	15
Figura 4. Ju lutem a mund të tregoni arsyen se pse ju mendoni se liria e shprehjes nuk garantohet plotësisht ose nuk garantohet aspak?	16
Figura 5. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së shprehjes? [Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht] Tabelimi i kryqëzuar me llojet e mediave.....	17
Figura 6. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së shprehjes? Prej 1 deri 10, 1 = “aspak” dhe 10 = “plotësisht”. Tabelimi i kryqëzuar në fushën kryesore të veprimit.	17
Figura 7. Ju lutem a mund të na tregoni pse besoni se garancitë ligjore në lidhje me lirinë e shprehjes nuk janë duke u zbatuar plotësisht, ose nuk janë duke u zbatuar aspak?	18
Figura 8. Sipas jush, a garantohet liria e informacionit me legjislacionin (Kushtetutën) e Kosovës?.....	19
Figura 9. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së informacionit? Vlerëso nga 1 tek 10, ku 1 = aspak dhe 10 plotësisht. Tabelimi i kryqëzuar me llojet e medimeve.	20
Figura 10. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së informacionit? Vlerëso nga 1 tek 10, ku 1 = aspak dhe 10 plotësisht. Tabelimi i kryqëzuar me llojet e medimeve bazuar në fushën kryesore të veprimit.....	21
Figura 11. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së informacionit? Vlerëso nga 1 tek 10, ku 1 = aspak dhe 10 plotësisht. Tabelimi i kryqëzuar me llojet e medimeve bazuar në etnicitet.....	21
Figura 12. Ju lutem a mund të na tregoni pse besoni se garancitë ligjore në lidhje me lirinë e informacionit nuk janë duke u zbatuar plotësisht, ose nuk janë duke u zbatuar aspak?	22
Figura 13. A funksionojnë mekanizmat rregullues të mediave (Komisioni i Pavarur për Media dhe Këshilli i Mediave të Shkurara të Kosovës) në mënyrë të paanshme dhe efektive?	23
Figura 14. A funksionojnë mekanizmat rregullues të mediave (KPM dhe KMSHK) në mënyrë të paanshme dhe efektive? Përgjigje të kombinuara “Po, plotësisht” dhe “Po, deri në një nivel” për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.....	24
Figura 15. A merren parasysh vendimet e trupave vetërregullues (KPM-së dhe KMSHK-së) nga organet e drejtësisë? Përgjigjet “Po”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në llojin e mediave.	24
Figura 16. A ka media politikisht të paanshme nga aspekti i politikave redaktuese?	25
Figura 17. Nëse Po, sa është numri i atyre të pavarura?.....	25
Figura 18. Në aspektin e politikave redaktuese dhe funksionimit të përditshëm, a është transmetuesi publik (RTK-ja) i pavarur nga ndërhyrjet politike?.....	26
Figura 19. A kanë mediat kod të etikës?.....	26
Figura 20. Në rast se besoni se mediat kanë kod të etikës, sa zbatohet ky kod? Prej 1 deri 10, 1 = “aspak” dhe 10 = “plotësisht”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në llojin e mediave.....	27
Figura 21. Personalisht, si e vlerësoni nivelin e profesionalizmit të gazetarëve në Kosovë? Prej 1 deri 10, ku 1 = “shumë joprofesional” dhe 10 = “shkëlqyeshëm” Tabelimi i kryqëzuar bazuar në fushën kryesore të veprimit	28

Figura 22. Si e vlerësoni nivelin e përgjithshëm të profesionalizmit të këtyre mediave? [Vlerësoni prej 1 deri 10, ku 1 = shumë joprofesional dhe 10 = shkëlqyeshëm].....	28
Figura 23. Sa të hapura janë këto institucione ndaj mediave? Vlerëso nga 1 deri 10, ku 1 do të thotë “aspak të hapura” dhe 10 “plotësisht të hapura”	29
Figura 24. A janë të hapura në mënyrë të njëjtë dhe të drejtë institucionet e mëposhtme për të gjitha mediat?	30
Figura 25. A janë të hapura në mënyrë të njëjtë dhe të drejtë institucionet e mëposhtme për të gjitha mediat? Përgjigjet “Po”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në llojin e mediave.....	31
Figura 26. A janë të hapura në mënyrë të njëjtë dhe të drejtë institucionet e mëposhtme për të gjitha mediat? Përgjigjet “Po”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në gjini.....	32
Figura 27. A e lejon legjislacioni i Kosovës, në ndonjë rast, censurën nga shteti?	33
Figura 28. Sipas jush, sa mundohen autoritetet shtetërore të censurojnë mediat? Tabelimi i kryqëzuar bazuar në regjion	34
Figura 29. A mund të na tregoni se sa është e rrezikuar liria e shprehjes? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak nuk është e rrezikuar” dhe 10 = “plotësisht e rrezikuar”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në fushën kryesore të veprimit.....	35
Figura 30. A mund të na tregoni se sa është e rrezikuar liria e shprehjes? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak nuk është e rrezikuar” dhe 10 = “plotësisht e rrezikuar”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në regjion.....	36
Figura 31. Në rast se besoni se liria e shprehjes është e rrezikuar në Kosovë, kush mendoni se e rrezikon atë?	37
Figura 32. A mund të na tregoni se sa është e rrezikuar liria e informacionit në Kosovë? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak e rrezikuar” dhe 10 = “plotësisht e rrezikuar”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në gjini	38
Figura 33. A mund të na tregoni se sa është e rrezikuar liria e informacionit në Kosovë? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak e rrezikuar” dhe 10 = “plotësisht e rrezikuar”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në regjion.....	38
Figura 34. Në rast se besoni se liria e informacionit është e rrezikuar në Kosovë, kush mendoni se e rrezikon atë?	39
Figura 35. A ndiqen penalisht gazetarët për shkak të lirisë së shprehjes dhe informacionit?	40
Figura 36. A ka parti politike apo individë të lidhur me parti politike që në mënyrë direkte apo indirekte drejtojnë mediat e tyre?	40
Figura 37. A ka ndërhyrje nga ana e pronarëve të mediave në punën e gazetarëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak” dhe 10 = “plotësisht”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në fushën kryesore të veprimit.....	42
Figura 38. A ka ndërhyrje nga ana e pronarëve të mediave në punën e gazetarëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak” dhe 10 = “plotësisht”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në grupmosha	43
Figura 39. Nga perspektiva juaja si gazetar, cilat janë pengesat më të mëdha në ushtrimin e profesionit të gazetarisë?	44
Figura 40. Sa janë të mbrojtura me legjislacion burimet e informacioneve të gazetarëve?	45
Figura 41. Sa zbatohen masat ligjore rreth mbrojtjes së ‘burimeve të gazetarëve’?	46
Figura 42. Personalisht, si do ti vlerësonit kushtet përgjithshme në të cilat punojnë gazetarët? Vlerëso prej 1 deri 10, ku 1 është “shumë keq” dhe 10 është “shumë mirë” Tabelimi i kryqëzuar bazuar në etnicitet.	46
Figura 43. Sipas jush, a janë gazetarët të kërcënuar nga dhuna fizike gjatë ushtrimit të detyrës së tyre?	47
Figura 44. A u ofrohet mbrojtja gazetarëve nga policia në rastet kur kërkohet?	47

Figura 45. A i trajtojnë institucionet e drejtësisë rastet e kërcënimit të gazetarëve në mënyrë adekuate (të duhur dhe të shpejtë)?	48
Figura 46. Sipas jush, a kanë gazetarët kontrata të rregullta të punës?	48
Figura 47. Nëse po, a zbatohen këto zbatohen?	49

Vërejtje

Të gjeturat e këtij studimi nuk paraqesin domosdoshmërisht mendimet dhe pikëpamjet e donatorit Civil Rights Defenders.

Mbështetur nga:



Partnerët bashkëpunues:



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

1. Hyrja

Ky dokument përshkruan analizën e zbatimit dhe të të dhënave të studimit kërkimor "Treguesit e Mediave 2015", të porositur nga Kosovo Global - Kosovo 2.0 dhe të kryer nga UBO Consulting. Fokusi i studimit ishte perceptimi aktual i gazetarëve në çështjet kryesore lidhur me mediat në Kosovë.

Objektivi kryesor i studimit ishte të përcaktonte dhe analizonte perceptimin e gazetarëve në Kosovë për lirinë e medias, bazuar në 27 tregues të Këshillit të Europës. Analiza është kategorizuar në gjashtë sektorë, duke mbuluar të gjitha fushat e studimit për të marrë informacion të rëndësishëm lidhur me perceptimin e gazetarëve dhe të lirisë së mediave:

- perspektiva ligjore dhe zbatueshmëria për lirinë e shprehjes dhe informacionit
- mekanizmat vetërregullues të mediave
- anshmëria e mediave dhe profesionalizmi
- transparencja e institucioneve në lidhje me mediat
- ndërhyrja në media
- siguria në gazetari

Historiku

Në vitin 2008, Këshilli i Europës ka hartuar "Treguesit për Mediat në një Demokraci", i cili përfshin 27 indikatorë për të matur dhe vlerësuar lirinë e shprehjes, lirinë e informacionit dhe lirinë e medias. Parlamenti i Këshillit të Europës e ka përshtatur këtë listë brenda kornizës së Rezolutës 1636/2008, duke u sugjeruar shteteve anëtare dhe parlamenteve kombëtare që të bëjnë raporte periodike bazuar në këtë listë.

Kosovo Global (Kosovo 2.0) në bashkëpunim me organizatat "Çohu" dhe Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës, dhe me mbështetjen financiare të Civil Rights Defenders, do të përdorë të 27 treguesit e mëposhtëm të Këshillit të Europës për të matur dhe vlerësuar kushtet e lirisë së mediave në Kosovë. Një pjesë e metodologjisë përfshin përgatitjen dhe zbatimin e një ankete, e cila do të përfshijë pyetje që janë të lidhura me 27 treguesit e Këshillit të Europës dhe do të zbatohet në mënyrë specifike me gazetarët.

Ky raport ka për qëllim të kapë vëmendjen e hartuesve të politikave të mediave, institucioneve përkatëse shtetërore, pronarëvetë mediave dhe profesionistëve, shoqatave dhe organizatave, ekspertëve të mediave dhe publikut të interesuar, me qëllim të zbatimit siç duhet në tërësi të sfidave ligjore, profesionale dhe institucionale në përputhje me treguesit e Këshillit të Europës.

Partnerët e projektit kanë kryer këtë studim gjithëpërfshirës për kushtete mediave, në përputhje me treguesit e Këshillit të Europës për mediat në demokraci. Kjo iniciativë do të krijojë dhe të ndihmojë për të zhvilluar vazhdimisht një model për një analizë të rregullt vjetore të situatës së përgjithshme të mediave në Kosovë. Aktivitete të ndryshme do të kryhengjaten vitit në mënyrë që të ndihmojnë identifikimin e çështjeve problematike dhe pengesave të mundshme, duke e bërë të mundshme për sipërmarrësit e sektorit të medias dhe aktorë tjerë relevantë që të kryejnë masat e nevojshme për t'i adresuar dhe zgjidhur këto çështje.

2. Metodologjia

Të dhënat e përdorura në këtë studim janë mbledhur nëpërmjet një serie votimi në kuadrin e projektit "Treguesit e Mediave në Kosovë". Metodologjia, madhësia e mostrës dhe instrumentet e sondazhit janë dizajnuar nga UBO Consulting në përputhje me termat e referencës dhe në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e partnerëve të projektit. Një varg intervistash janë kryer me gazetarë në tërë Kosovën në media të ndryshme. Pyetjet janë shqyrtuar dhe jemi pajtuar reciprokisht që të bëhen në fillim të shkurtit 2015.

2.1 Madhësia e mostrës

Madhësia e mostrës për këtë studim ka qenë 175 intervista. Puna në terren është kryer në periudhën 11 shkurt-16 mars 2015. Ky studim përdorë mostër të shtresuar në disa faza.

Prej 175 të anketuarve, 55 për qind ishin meshkuj dhe 45 për qind femra. Kategorizimi i grupmoshave zbulon se 59 për qind e të anketuarve ishin nën moshën 35, 34 për qind ishin të moshave 35 deri 54, dhe 7 për qind ishin të moshës 55 ose më të vjetër. Përkatësia etnike e të anketuarve, bazuar në mostrën e zgjedhur është 81 për qind shqiptarë të Kosovës, 14 për qind serbë të Kosovës dhe pakicat e tjera janë të përfaqësuar me 5 për qind.

Gjashtë për qind e të anketuarve kanë mbaruar arsimim e shkollës së mesme, 75 për qind kanë studimet e fakultetit, ndërsa 19 për qind kanë raportuar se kanë nivelin master të kualifikimit.

Lloji i Mediave	Regjioni							Total
	Prishtina	Mitrovica	Prizreni	Peja	Ferizaj	Gjakova	Gjilani	
TV	30	6	11	6	8	4	4	69
Radio	16	9	6	4	1	2	8	46
Fletushkë	21	2	2	1	2	2	1	31
Portal	19	2	1	1	2	2	2	29
Total	86	19	20	12	13	10	15	175

2.2 Kufizimet

Më poshtë janë disa nga sfidat/kufizimet që kanë dalë gjatë procesit të mbledhjes dhe analizës së këtij studimi:

i. Mediatë ndryshme (gazetat, portalet, dhe radiot) nuk ishintë arritshme, edhe pse ne i kemi shënuar më parë ato si të përshtatshme për intervista.

II. Gjatë procesit të intervistimit, ne kemi hasur në raste të shumta ku gazetarët e mediave lokale ishin gjithashtu korrespondentët e mediave me bazë në Prishtinë.

III. Një numër i madh i mediave të Kosovës (përveç atyre kombëtare dhe Klan Kosova) nuk kanë gazetarë me profil specifik për politikë dhe ekonomi. Kështu, përfshim gazetarë që mbulojnë fusha të tjera.

IV. Disa media që kanë show televizivë, fletushkë ose portal nuk kanë në mënyrë specifike gazetarë hulumtues për mediat përkatëse, por të njëjtit gazetarë kryejnë punën për të trija këto.

V. Një numër i madh i radiove lokale nuk kanë gazetarë pasi që ato nuk janë të përfshira në prodhimin e lajmeve, por vetëm në transmetim të muzikës.

VI. Studimi është kryer me gazetarët e etnive të ndryshme, ndërsa një fokus i rëndësishëm i është kushtuar barazisë gjinore (megjithëse barazia e plotë ishte e vështirë për t'u arritur).

3. Përmbledhje Ekzekutive

Ky dokument paraqet rezultatet e një studimi në mbarë Kosovën, porositur nga KosovoGlocal (Kosovo 2.0) dhe partnerët Çohu dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, dhe zbatuar nga UBO Consulting. Fokusi i studimit është media, gazetarët dhe liria e shprehjes në Kosovë.

Ky studim do të paraqesë të dhëna relevante për të ndihmuar në reformimin e sistemit aktual të Kosovës në përputhje me Treguesit e Këshillit të Europës për Demokraci. Informacionet dhe gjetjet janë kategorizuar si më poshtë:

- perspektiva ligjore dhe zbatueshmëria për lirinë e shprehjes dhe informacionit
- mekanizmat (vetë)rregullues të mediave
- anshmëria e mediave dhe profesionalizmi
- transparenca e institucioneve në lidhje me mediat
- ndërhyrja në media
- siguria në gazetari

Gjetjet kryesore

Perspektiva ligjore dhe zbatueshmëria për lirinë e shprehjes dhe informacionit

- Shumica e gazetarëve besojnëse Kushtetuta e Kosovës garanton lirinë e shprehjes. 52 për qind kanë qenë krejtësisht të sigurtë dhe 26 për qind besonin se liria e shprehjes është e garantuar "deri në një nivel".
- Gazetarët janë të mendimit se garancitë ligjore në lidhje me lirinë e shprehjes nuk janë duke u zbatuar në një nivel të dëshirueshëm.
- Të anketuarit e angazhuar në ekonomi prirën të besojnë se garancitë përsa i përket lirisë së shprehjes janë zbatuar më shumë se ato ku fusha ekspertizës është drejtësia.
- Arsyet kryesore të të anketuarit që ishin skeptikë në lidhje me zbatimin e garancive ligjore për lirinë e shprehjes ishin "ndërhyrje nga individë të përfshirë në politikë" (22%), "ndërhyrje nga pronarëte medias" (14%) dhe "ndërhyrje nga qeveria" (13%).

- Shtatëdhjetë e katër për qind besojnë se liria e informacionit ose është e garantuar plotësisht (46%), ose e garantuar për një nivel (28%) me Kushtetutën e Kosovës.
- Të anketuarit që punojnë në radio dhe televizione priren të besojnë se garancitë ligjore në lidhje me lirinë e informacionit nuk janë zbatuar plotësisht. Ata që punojnë në gazeta dhe portale kanë më shumë gjasa të besojnë se garancitë tilla janë zbatuar në të vërtetë.
- Ndikimi i mediave përgjithësisht buron nga "individëte përfshirë në politikë" (18%), "pronarët e mediave" (12%) dhe "qeveria" (12%).

Mekanizmat (vetë)rregullues të mediave

- Mbi 65 për qind e të anketuarve besojnë gjerësisht se mekanizmat rregullues të mediave (Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës) funksionojnë në mënyrë efektive dhe pa anësi.
- Për vendimet e marra nga Komisioni i Pavarur për Media, mbi 40 për qind e të anketuarve besojnë se ato janë marrë parasysh nga institucionet e drejtësisë. Në mënyrë të ngjashme, për vendimet e marra nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, mbi 34 për qind e të anketuarve besojnë se edhe ato janë marrë parasysh nga këto institucione.
- Të anketuarit të cilët operojnë në TV dhe mediajanë më të bindur se vendimet e marra nga mekanizmat vetërregulluese (KPM dhe KMSHK) janë marrë parasysh nga organet/institucionet e drejtësisë.

Anshmëria e mediave dhe profesionalizmi

- Dyzet e nëntë për qind e të anketuarve pohojnë se ka media të paanshme nga aspekti i editorialeve, ndërsa 38 për qind pohojnë se nuk ka media të paanshme.
- Nga perspektiva e politikave editoriale dhe operacioneve të përditshme, të anketuarit në përgjithësi besojnë se transmetuesi publik nuk është i pavarur apo i paanshëm nga ndërhyrjet politike. Në total 55 për qind e tyre pohojnë se transmetuesi nuk është "aspak" i pavarur dhe 20 për qind pohojnë se është "jo i pavarur, deri në një nivel të caktuar."
- Saktësisht 60 për qind e të anketuarve pohojnë se ka një kod të etikës së mediave në funksion, ndërsa 15 për qind pohojnë të kundërtën.

- Të anketuarit që operojnë në gazeta janë më të sigurtë se kodi i etikës është aplikuar në mënyrë të plotë.
- Niveli i profesionalizmit në mediat e Kosovës është parë si mesatar.

Transparenca e institucioneve në lidhje me mediat

- Vetëm "policia" dhe "komunat" perceptohen disi si të hapura ndaj mediave. Institucionet tjera janë afër mesatares ose nën mesatare me institucionin më së paku të hapur që është "EULEX".
- Institucioni më i hapur në mënyrë të drejtë dhe të barabartë është "Policia" (52%), pas saj vjen "Kuvendi i Kosovës" (40%), "Presidenca" (39%) dhe "Komunat" (38%).

Ndërhyrja në media

- Gjashtëmbëdhjetë për qind besojnë se legjislacioni lejon censurën shtetërore, 34 për qind nuk besojnë kështu, ndërsa 49 për qind nuk kishin asnjë informacion mbi këtë temë.
- Autoritetet shtetërore nuk janë të përqendruara kryesisht në censurimin e medias.
- Të anketuarit nga rajoni i Gjilanit dhe Prizrenit janë më pak të shqetësuar me censurën e mediave nga ana e shtetit, kurse ata nga Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina tregojnë më shumë shqetësim.
- Në një shkallë nga 1 në 10, me 1 "e parrezikuar fare" dhe 10 "krejtësisht e rrezikuar", vlerësimi mesatar i të anketuarve mbi rrezikimin e lirisë së shprehjes qëndron në 6,59.
- Ata që bëjnë gazetari në fushën e drejtësisë pohojnë më së shumti se liria e shprehjes është e rrezikuar në Kosovë, ndërsa ata që trajtojnë çështjet sociale kanë një mendim pak më të relaksuar për këtë çështje.
- "Individët nga politika" (32%), "individët nga bizneset" (18%), "qeveria" (16%) dhe "pronarët e mediave" (15%) janë mbajtur përgjegjës më së shumti për rrezikimin e medias.
- Të anketuarit besojnë fuqimisht se ka parti politike apo individë me lidhje të partive politike që drejtpërdrejt ose tërthorazi drejtojnë mediat. Mbi 82 për qind e tyre besojnë kështu për partitë politike, ndërsa 86 për qind e tyre besojnë kështu për individët me lidhje me partitë politike.

Siguria në gazetari


- Dyzet e gjashtë për qind e të anketuarve besojnë se burimet e tyre të informacionit janë të mbrojtura "në një nivel", me vetëm 16 për qind që deklarojnëse janë "krejtësisht" të mbrojtura me legjislacionin aktual.
- Pesëdhjetë e gjashtë për qind e të anketuarve pohojnë se masat ligjore në lidhje me mbrojtjen e burimeve të gazetarëve janë ekzekutuar vetëm në "një nivel".
- Kushtet e përgjithshme brenda të cilit gazetarët aktualisht kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme konsiderohen si mbimesatare.
- Shqiptarët e Kosovës përgjithësisht vlerësojnë situatën si më të keqe (4,42), në krahasim me serbët e Kosovës që kanë një mendim mjaft pozitiv (1,42) lidhur me kushtet e përgjithshme në të cilat gazetarët kryejnë punën e tyre të përditshme.
- Mbi 62 për qind e të anketuarve pohojnë se ata janë të kërcënuar me dhunë "deri në një farë niveli," dhe 22 për qind thonëse ata janë "plotësisht" të kërcënuar.
- Katërbëdhjetë për qind nga të anketuarit pohojnë se mbrojtja e policisë është ofruar "plotësisht", 56 për qind e të anketuarve pohojnëse ajo është ofruar "deri në një nivel".
- Të anketuarit besojnë se rastet e kërcënimitose janë trajtuar "plotësisht" (7%) në mënyrë adekuate, ose "deri në një nivel" (46%).
- Dyzet e pesë për qind e të anketuarve nuk kanë kontrata të rregullta të punësimit, 33 për qind pohojnë se kanë, dhe 22 për qind nuk e kanë këtë informacion.

4. Rezultatet

4.1 Perspektiva legale dhe zbatueshmëria e lirisë së shprehjes dhe informacionit


Studimi zbulon se shumica e gazetarëve besojnë se Kushtetuta e Kosovës garanton lirinë e shprehjes. Pesëdhjetë e dy për qind kanë qenë krejtësisht të sigurtë dhe 26 për qind besonin se liria e shprehjes është e garantuar "deri në një nivel". Ndërkohë, 8 për qind besojnë se liria e tillë është "jo tërësisht" e garantuar, 8 për qind janë të sigurtë se nuk ka garanci, ndërsa pjesa e mbetur, 6 për qind, nuk kanë informacion për t'u përgjigjur.

Figura 1. Sipas jush, a garantohet liria e shprehjes me legjislacionin (Kushtetutën) e Kosovës




Një analizë e plotë tregon se ka një dallim të vogël midis mendimit të atyre që punojnë në TV, radio, agjenci të gazetave dhe portaleve. Në mënyrë të veçantë, përqindja e të anketuarve që besojnë se liria e shprehjes është me siguri e garantuar me legjislacionin e Kosovës është më e vogël për ata që veprojnë në radio (39%) dhe TV (52%), në krahasim me ata që veprojnë në gazeta (68%) apo portale (59%).

Figura 2. Sipas jush, a garantohet liria e shprehjes me legjislacionin (Kushtetutën) e Kosovës? Përgjigje "Po, plotësisht". Tabelim i kryqëzuar me llojet e mediave




Sa i përket përkatësisë etnike, shqiptarët e Kosovës ka më shumë gjasa të raportojnë se liria e shprehjes është e garantuar me Kushtetutën e Kosovës, kurse serbët e Kosovës përgjithësisht thonë të kundërtën, ose se nuk kanë informacion.

Figura 3. Sipas jush, a garantohet liria e shprehjes me legjislacionin (Kushtetutën) e Kosovës? Përgjigje të kombinuara. Tabelim i kryqëzuar bazuar në etnicitet



Nga ata që nuk janë krejtësisht të sigurtë, apo besojnë se Kushtetuta e Kosovës nuk garanton lirinë e shprehjes, 48 për qind pohojnë se arsyeja e tyre është "zbatimi i gabuar i ligjit nga ana e autoriteteve përgjegjëse", 41 për qind thonë se kjo është për shkak të "legjislacionit jo të plotë" dhe 30 për qind për shkak të "mungesës së legjislacionit të drejtpërdrejtë (për = lirinë e shprehjes dhe të informacionit)." Vetëm disa të anketuar (13%) thonë se përgjigjia e tyre e mëparshme është bazuar në faktin se ka një "zbatim jokorrekt nga organet e drejtësisë".


Figura 4. Ju lutem a mund të tregoni arsyen se pse ju mendoni se liria e shprehjes nuk garantohej plotësisht ose nuk garantohej aspak?



Të anketuarit besojnë se garancitë ligjore në lidhje me lirinë e shprehjes janë duke u zbatuar me ritme relativisht të ulëta. Të dhënat zbulojnë se në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 do të thotë "nuk janë zbatuar garancitë ligjore" dhe 10 do të thotë "janë zbatuar plotësisht," mesatarja është nën pikën e rentabilitetit - 4,53. Ky rezultat tregon se gazetarët janë të mendimit të përgjithshëm se garancitë ligjore në lidhje me lirinë e shprehjes nuk janë duke u zbatuar në një nivel të dëshirueshëm. Edhe pse variacioni i përgjigjeve ishte i lartë (devijimi standard = 2), mesatarja e përgjithshme tregon një mungesë besimi ndaj zbatimit të garancive ligjore për lirinë e shprehjes në Kosovë.


Ka një ndryshim në vlerësimin në mesin e të anketuarve, bazuar në mediumin e tyre të veprimit. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit të cilët veprojnë në portale kanë një mesatare më të lartë të vlerësimit (5,34) në krahasim me ata që veprojnë në radio (4,02).

Figura 5. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së shprehjes? [Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht] Tabelimi i kryqëzuar me llojet e mediave.




Në të njëjtën kohë, ka pasur dallime në vlerësim në mes të të anketuarve, bazuar në fokusin/fushën e tyre të profesionit. Të anketuarit e angazhuar në ekonomi priren të besojnë se garancitë përsa i përket lirisë së shprehjes janë zbatuar më shumë se të anketuarit fushae ekspertizës e të cilëve është drejtësia, ose një kombinim i të gjitha fushave. Më poshtë është një prezantim i shkurtër i rezultateve të vlerësimit nga fusha e fokusit të secilit të anketuar.

Figura 6. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së shprehjes? Prej 1 deri 10, 1 = “aspak” dhe 10 = “plotësisht”. Tabelimi i kryqëzuar në fushën kryesore të veprimit.



Nga të anketuarit që ishin skeptikë për zbatimin e garancive ligjore për lirinë e shprehjes, arsyet kryesore sipas mendimeve të tilla ishin "ndërhyrja nga individë të përfshirë në politikë" (22%), "ndërhyrja nga pronarë të medias" (14%) dhe "ndërhyrja nga Qeveria"(13%). Sipas tyre, arsyet e tilla së bashku me shumë forma të tjera të ndërhyrjeve ndikojnë drejtpërdrejt aftësinë për të zbatuar të drejtat e lirisë së shprehjes në profesionin e tyre.


Figura 7. Ju lutem a mund të na tregoni pse besoni se garancitë ligjore në lidhje me lirinë e shprehjes nuk janë duke u zbatuar plotësisht, ose nuk janë duke u zbatuar aspak?



Pyetje identike u janë prezantuar të intervistuarve në lidhje me lirinë e informacionit në Kosovë. Të dhënat zbulojnë se gazetarët besojnë se liria e informacionit duhet të garantohet gjerësisht me Kushtetutën e Kosovës.

Shumica e 74 për qind besojnë se liria e informacionit është ose e garantuar plotësisht (46%), ose e garantuar në një nivel (28%) me Kushtetutën e Kosovës. Vetëm 18 për qind janë të mendimit se liria e informacionit ose nuk është e garantuar tërësisht (7%) ose nuk është e garantuar aspak (11%).

Figura 8. Sipas jush, a garantohet liria e informacionit me legjislacionin (Kushtetutën) e Kosovës?




Nga ata që nuk janë krejtësisht të sigurtë, apo besojnë se Kushtetuta e Kosovës nuk garanton lirinë e informacionit, 38 për qind pohojnë se arsyeja e tyre është "aplikimi i gabuar (i këtij ligji) nga autoritetet përgjegjëse," 29 për qind thonë se arsyeja është "legjislacion i paplotë", 23 për qind thonë se "mungesa e legjislacionit të drejtpërdrejtë (për këtë ligj)", dhe 10 për qind thonë se arsyeja është "aplikimi i pasaktë nga organet e drejtësisë".

Të anketuarit janë pyetur se në çfarë mase ata besojnë se garancitë ligjore për sa i përket lirisë së informacionit janë duke u zbatuar. Në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 do të thotë "nuk ka zbatim të garancive ligjore" dhe 10 do të thotë "ka zbatim të plotë", rezultati mesatar është 4,94. Kjo tregon se ka një neutralitet të përgjithshëm në efektivitetin e këtij ligji, dhe se gazetarët nuk janë të kënaqur me normën e tanishme të zbatimit të tij.


Analiza e të dhënave tregon se të anketuarit që punojnë në radio dhe TV priren të besojnë se garancitë ligjore në lidhje me lirinë e informacionit nuk janë zbatuar plotësisht. Ndërkohë, ata të cilët punojnë në gazeta dhe portale kanë më shumë gjasa për të besuar se garancitë e tilla janë zbatuar në të vërtetë.

Figura 9. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së informacionit? Vlerëso nga 1 tek 10, ku 1 = aspak dhe 10 plotësisht. Tabelimi i kryqëzuar me llojet e mediemeve.




Në mënyrë të ngjashme, ka pasur dallime në vlerësim mes të anketuarve, bazuar në fokusin e tyre të profesionit. Të anketuarit e angazhuar në ekonomi priren për të besuar se garancitë për sa i përket lirisë së informacionit janë zbatuar më shumë sesa të anketuarit fusha e ekspertizës së të cilëve është kultura apo drejtësia. Më poshtë është një prezantim i shkurtër i rezultateve mbi vlerësimin nga fusha e fokusit të secilit të anketuar.

Figura 10. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së informacionit? Vlerëso nga 1 tek 10, ku 1 = aspak dhe 10 plotësisht. Tabelimi i kryqëzuar me llojet e mediave bazuar në fushën kryesore të veprimit




Megjithatë, ka një dallim në mendime mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Përderisa shqiptarët janë të prirur për të deklaruar se garancitë ligjore në lidhje me lirinë e informacionit janë zbatuar disi (5,36), serbët deklarojnë se ka mungesë pothuajse të plotë të zbatimit - 2,13.

Figura 11. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së informacionit? Vlerëso nga 1 tek 10, ku 1 = aspak dhe 10 plotësisht. Tabelimi i kryqëzuar me llojet e mediave bazuar në etnicitet



Në mënyrë që të kuptojmë arsyet për këtë pakënaqësi, kemi pyetur respondentët të cilët e kanë vlerësuar pyetjen e mëparshme, mes shifrave 1 në 5 për organet përgjegjëse që ata besojnë se janë të përfshira në këtë situatë. Shumica e ndërhyrjes me sa duket buron nga "individë të përfshirë në politikë" (18%), "pronarët e mediave" (12%) dhe "qeveria" (12%). Arsye të tjera janë gjithashtu në afërsi, me më pak ndërhyrje të përmendura nga "gjykatat" (4%), "ndërkombëtarët" (3%) dhe "policia" (3%).

Figura 12. Ju lutem a mund të na tregoni pse besoni se garancitë ligjore në lidhje me lirinë e informacionit nuk janë duke u zbatuar plotësisht, ose nuk janë duke u zbatuar aspak?




4.2 Mekanizmat (vetë)rregullues të mediave

Sa për mekanizmat (vetë)rregullues të mediave, ka një bazë të përbashkët rreth funksionalizimit të saj, efektivitetit dhe zbatueshmërisë së ligjit. Të anketuarit besojnë gjerësisht se mekanizmat (vetë)rregullues të mediave (Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës) funksionojnë në mënyrë efektive dhe pa paragjykim.

Në mënyrë të veçantë, në lidhje me Komisionin e Pavarur të Mediave, 16 për qind besojnë se ai funksionon "krejtësisht" në mënyrë efektive dhe pa paragjykim, 53 për qind


"deri në një nivel", 11 për qind "jo krejtësisht" dhe 20 për qind "aspak". Në të njëjtën notë, lidhur me Këshillin e Mediave të Kosovës, 17 për qind besojnë se funksionon "krejtësisht", 50 për qind "deri në një nivel", 14 për qind "jo krejtësisht" dhe 19 për qind "aspak".

Figura 13. A funksionojnë mekanizmat rregullues të mediave (Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës) në mënyrë të paanshme dhe efektive?



Të anketuarit që veprojnë në gazeta ishin më të sigurtë se Komisioni i Pavarur për Media dhe Këshilli i Mediave të Kosovës funksionojnë në mënyrë efektive dhe pa paragjykim. Të dhënat e kombinuara për përgjigje me "po, plotësisht" dhe "po, deri në një nivel" lidhur me efektivitetin eKPM-së dhe KMSHK-së tregojnë se të anketuarit nga gazetatat janë më të bindur se atanga TV, radio dhe portale. Grafiku më poshtë tregon të dhënat e kombinuara dhe krahasimin për të gjitha llojet e mediave.


Figura 14. A funksionojnë mekanizmat rregullues të mediave (KPM dhe KMSHK) në mënyrë të paanshme dhe efektive? Përgjigje të kombinuara “Po, plotësisht” dhe “Po, deri në një nivel” për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës



Vendimet e marra nga këta mekanizma rregullues në përgjithësi merren seriozisht nga ana e institucioneve të drejtësisë. Studimi zbulon se për vendimet e marra nga Komisioni i Pavarur për Media, mbi 40 për qind e të anketuarve besojnë se ato janë marrë parasysht nga institucionet e drejtësisë. Në mënyrë të ngjashme, për vendimet e marra nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, mbi 34 për qind e të anketuarve besojnë se ato janë marrë parasysht nga institucionet e drejtësisë. Këto shifra janë të rëndësishme duke pasur parasysht se mbi 40 për qind e të anketuarve të mbetur nga të dy grupet nuk kanë informacion mbi këtë temë.

Kur krahasohen rezultatet midis llojeve të mediave, rezulton se të anketuarit të cilët veprojnë në TV dhe mediat e gazetave janë më të bindur se vendimet e marra nga mekanizmat (vetë)rregullues (KPM dhe KMSHK) janë marrë parasysht nga organet/institucionet e drejtësisë.


Figura 15. A merren parasysht vendimet e trupave (vetë)rregullues (KPM-së dhe KMSHK-së) nga organet e drejtësisë? Përgjigjet “Po”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në llojin e mediave.



4.3 Anshmëria e mediave dhe profesionalizmi


Studimi hulumton fusha të ndryshme të njëanshmërisë së mediave dhe profesionalizmit në Kosovë. Të dhënat zbulojnë se të anketuarit janë të ndarë në mendim kur janë pyetur se a ka media të paanshme nga aspekti i politikave redaktuese. Mbi 49 për qind e tyre thonë se nuk ka media të paanshme nga aspekti i pjesëve redaktuese, 38 për qind pohuan se nuk ka media të paanshme, dhe 13 për qind nuk kanë pasur një përgjigje.

Figura 16. A ka media politikisht të paanshme nga aspekti i politikave redaktuese?




Nga ata që besojnë se ka media të paanshme, shumica e tyre besojnë se ato ekzistojnë në "numër të vogël" (58%), ndërsa më pak prej tyre shohin "gjysmën e tyre" (10%) ose "shumicën e tyre, jo të gjitha" (12%), si të pavarura. Vlen të theksohet se vetëm 1 për qind pohuan se të gjitha mediat janë të pavarura ndërsa 19 për qind nuk ishin në gjendje për të vlerësuar këtë shifër.

Figura 17. Nëse Po, sa është numri i atyre të pavarura?




Për më tepër, të anketuarit kanë dhënë mendime mbi transmetuesin publik - Radio Televizionin e Kosovës. Nga perspektiva e politikave editoriale dhe veprimtarisë së përditshme, të anketuarit në përgjithësi besojnë se transmetuesi publik nuk është i pavarur apo i paanshëm nga ndërhyrjet politike. Një total prej 55 për qind të tyre pohojnë se transmetuesi nuk është "aspak" i pavarur dhe 20 për qind pohojnë se është "jo i pavarur, deri në një nivel të caktuar", ndërsa shifra pozitive mbeten të ulëta.

Figura 18. Në aspektin e politikave redaktuese dhe funksionimit të përditshëm, a është transmetuesi publik (RTK-ja) i pavarur nga ndërhyrjet politike?



Rezultatet tregojnë se ekziston një nivel i sigurisë në lidhje me atë nëse mediat kanë një kod etik. Saktësisht 60 për qind e të anketuarve të intervistuar pohuan se mediat kanë një kod të etikës në funksion, 15 për qind pohuan të kundërtën, ndërsa 25 për qind e mbetur nuk kishte informacion.


Figura 19. A kanë mediat kod të etikës?



Të anketuarit që kanë deklaruar se ka pasur një kod të etikës të mediave janë pyetur më tej në lidhje me shkallën në të cilën ky kod është zbatuar. Në një shkallë nga 1 në 10, me 1 duke qenë "aspak" dhe 10 duke qenë "plotësisht", rezultati ka dalë 5,64. Kjo shifër tregon se të anketuarit nuk besojnë se kodi i etikës në media është aplikuar në mënyrë të plotë, dhe se një zbatim mesatar nuk është parë si i mjaftueshëm.

Të dhënat e analizës së kryqëzuar tregojnë se të anketuarit që veprojnë në mediat e gazetave janë më të sigurtë se kodi i etikës është aplikuar plotësisht, derisa vlerësimi mesatar për ta qëndron në 6,48.


Figura 20. Në rast se besoni se mediat kanë kod të etikës, sa zbatohet ky kod? Prej 1 deri 10, 1 = "aspak" dhe 10 = "plotësisht". Tabelimi i kryqëzuar bazuar në llojin e mediave.



Niveli i profesionalizmit në mediat e Kosovës është parë si mesatar. Rezultatet e anketës tregojnë se kur janë pyetur se si të anketuarit e vlerësojnë nivelin e profesionalizmit të gazetarëve, në një shkallë nga 1 deri në 10, 1 duke qenë "shumë joprofesionale" dhe 10 duke qenë "e shkëlqyer", rezultati i vlerësimit ka dalë 5,30.

Analiza e kryqëzuar e të dhënave në mes të të anketuarve me prejardhje të ndryshme vepruese, tregon se ata që punojnë në fushën e ekonomisë kanë një tendencë më të lartë për të deklaruar se niveli i profesionalizmit të gazetarëve të Kosovës është afër "i shkëlqyer", ndërsa ata që kryejnë punën në kulturë besojnë se ky nivel është pothuajse plotësisht "joprofessional".


Figura 21. Personalisht, si e vlerësoni nivelin e profesionalizmit të gazetarëve në mediat kosovare? Prej 1 deri 10, ku 1 = “shumë joprofesional” dhe 10 = “shkëlqyeshëm” Tabelimi i kryqëzuar bazuar në fushën kryesore të veprimit



Në mënyrë të ngjashme, kur janë pyetur rreth asaj se sa i beson publiku mediave, në një shkallë nga 1 deri në 10, me 1 duke qenë "aspak" dhe 10 duke qenë "plotësisht", rezultati ka dalë 5,66. Kjo shifër tregon se niveli i besimit është relativisht pozitiv, edhe pse shumë punë mbetet për t'u bërë në këtë drejtim.

Në mënyrë të veçantë, studimi ka analizuar vlerësimin e profesionalizmit brenda llojeve kryesore të mediave - TV, radio, gazeta dhe portale. Në një shkallë nga 1 në 10, me 1 duke qenë "shumë joprofesionale" dhe 10 "shkëlqyeshëm", rezultatet më të mira ishin ato të televizionit në 6,40, pasuar nga gazetatat në 6,12, pastaj radiot në 5,53 dhe së fundi me nivelin më të varfër të profesionalizmit, portalet në 4,34.


Figura 22. Si e vlerësoni nivelin e përgjithshëm të profesionalizmit të këtyre mediave? [Vlerësoni prej 1 deri 10, ku 1 = shumë joprofesional dhe 10 = shkëlqyeshëm]



4.4 Transparenca e Institucioneve në lidhje me media


Të dhënat tregojnë se institucionet publike dhe agjencitë e ndryshme nuk janë veçanërisht të hapura ndaj mediave. Nga shumë institucione të përfshira në këtë studim, vetëm "policia" dhe "komunat" perceptohen si disi të hapura ndaj mediave. Pjesa tjetër e tyre, bien afër mesatares ose nën mesatare me institucionin më së paku të hapur, e që është "EULEX" (3,94 mesatarja).

Figura 23. Sa janë të hapura këto institucione ndaj mediave? Ju lutem vlerësoni nga 1 deri 10, ku 1 do të thotë "aspak të hapura" dhe 10 "plotësisht të hapura"




Hulumtimet e mëtejme tregojnë se të anketuarit besojnë se jo të gjitha institucionet janë në mënyrë të barabartë dhe mjaft të hapura për të gjitha mediat. Sipas tyre, institucioni më i hapur në mënyrë të drejtë dhe të barabartë është "Policia" (52%), e cila pasohet nga "Kuvendi i Kosovës" (40%), "Presidenca" (39%) dhe "Komunat" (38%). Një nga institucionet më pak të besuara në lidhje me trajtimin e barabartë dhe korrekt në të gjitha mediat është "Qeveria e Kosovës."

Figura 24. A janë të hapura në mënyrë të njëjtë dhe të drejtë institucionet e mëposhtme për të gjitha mediat?




Për të kuptuar perspektivën për secilin grup të synuar nga të anketuarit që veprojnë në llojet e ndryshme të mediave, ne duhet të shohim të dhënat në tabelën më poshtë. "Policia" është institucioni më i drejtë dhe i barabartë kur bëhet fjalë për trajtimin e të gjitha llojevetë mediave, me shifrën më të lartë për gazetatat (68%). Shifrat mbeten afër mesatares, duke ditur se ekziston një diversitet i mendimeve që variojnë nga një medium në tjetrin.

Figura 25. A janë të hapura në mënyrë të njëjtë dhe të drejtë institucionet e mëposhtme për të gjitha mediat? Përgjigjet "Po". Tabelimi i kryqëzuar bazuar në llojin e mediave.



Kur krahasojmë rezultatet sipas gjinisë, vërejmë luhatje të vogla në mes të të gjitha institucioneve. Respondentët meshkuj ka më pak të ngjarë të besojnë se "policia" (47%) është në mënyrë të barabartë dhe mjaft e hapur për të gjitha mediat, në krahasim me femrat (58%). Hendeku më i gjerë në opinionin duket të jetë ai në institucionet "gjyqësore", ku të anketuarat femra pothuajse tërësisht (19%) nuk pajtohen mbi drejtësinë dhe barazinë e tyre ndaj të gjitha mediave, ndërsa pjesëmarrësit meshkuj janë më optimistë në këtë temë (32%). Më poshtë janë rezultatet për të gjitha institucionet dhe opinionet specifike gjinore.


Figura 26. A janë të hapura në mënyrë të njëjtë dhe të drejtë institucionet e mëposhtme për të gjitha mediat? Përgjigjet "Po". Tabelimi i kryqëzuar bazuar në gjini.



4.5 Ndërhyrja në media

Të anketuarit janë pyetur nëse ata mendojnë se legjislacioni i Kosovës lejon censurën shtetërore në çdo pikë. Gjashtëmbëdhjetë për qind besojnë se legjislacioni lejon censurën shtetërore, 34 për qind nuk besojnë kështu, ndërsa 49 për qind nuk kishin asnjë informacion mbi këtë temë.

Figura 27. A e lejon legjislacioni i Kosovës, në ndonjë rast, censurën nga shteti?




Nga të anketuarit që besojnë se censura shtetërore është e lejuar, skenari më i zakonshëm ishte lidhur me "dokumentet zyrtare/konfidenciale shtetërore", "censurën e raportimit të ndonjë trazire sociale" dhe "censurën e raportimit të çfarëdo konflikti apo krize". Një analizë e procesimit të fjalëvetregon se frazat më të zakonshme të përdorura për t'iu përgjigjur kësaj pyetje ishin: "kufizime", "raportim" dhe "konfidencial".

Sipas të anketuarve, autoritetet shtetërore nuk janë të përqendruara kryesisht në censurimin e medias, nga 1 tek 10, me 1 duke qenë "nuk ka censurë" dhe 10 duke qenë "censurë e plotë" mesatarja del në 5,38.

Të anketuarit nga rajoni i Gjilanit (4,13) dhe Prizrenit (4,40) janë më pak të shqetësuar për censurë të mediave nga ana e shtetit, kurse ata nga Ferizaj (5,77), Mitrovica (5,74) dhe Prishtina (5,71) tregojnë më shumë shqetësim.

Figura 28. Sipas jush, sa mundohen autoritetet shtetërore të censurojnë mediat? Tabelimi i kryqëzuar bazuar në regjion




Nga të anketuarit që ishin të sigurtë se shteticensuron mediat¹, metoda më e zakonshme e shfaqjes është me anë të "pushimit të mbështetjes financiare" dhe "presionit të theksuar politik mbi gazetarët". Fjalët më të zakonshme të përdorura për t'iu përgjigjur kësaj pyetje ishin: "presion", "kushtëzim" dhe "interes".

Të anketuarit u pyetën pastaj nëse ata mendonin se liria e shprehjes është e rrezikuar në Kosovë. Në një shkallë nga 1 në 10, me 1 duke qenë "nuk rrezikohet fare" dhe 10 duke qenë "krejtësisht e rrezikuar," mesatarja qëndron në 6,59. Kjo shifër tregon se të anketuarit janë të shqetësuar gjerësisht në lidhje me implikimet aktuale dhe potenciale të ardhshme mbi shtypjen e shprehjes.

¹Respondentët që më parë vlerësonin 5-10 për censurën shtetërore.


Bazuar në fushat kryesore të veprimit të të anketuarve, ata të cilët bëjnë gazetari në fushën e drejtësisë thonë se liria e shprehjes është më e rrezikuar në Kosovë. Nga ana tjetër, ato që trajtojnë çështje sociale kanë një mendim pak më të relaksuar për rrezikimin e lirisë së shprehjes në Kosovë.

Figura 29. A mund të na tregoni se sa është e rrezikuar liria e shprehjes? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak nuk është e rrezikuar” dhe 10 = “plotësisht e rrezikuar”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në fushën kryesore të veprimit.




Në lidhje me lirinë e shprehjes, ka dallime të vogla në perceptim në bazë të rajoneve. Të anketuarit nga Mitrovica (7,37) dhe Prizreni (7,05) janë më të shqetësuar për rrezikimin e lirisë së shprehjes, ndërsa ata nga Ferizaj (5,69) dhe Gjakova (5,10) janë më pak të shqetësuar.

Figura 30. A mund të na tregoni se sa është e rrezikuar liria e shprehjes? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak nuk është e rrezikuar” dhe 10 = “plotësisht e rrezikuar”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në rajon.



Nga të anketuarit që ishin të sigurtë se liria e shprehjes është e rrezikuar², palët më përgjegjëse për këtë rrezikim mbahen "individët nga politika" (32%), "individët nga bizneset" (18%), "qeveria" (16%) dhe "pronarët e mediave" (15%).

Figura 31. Në rast se besoni se liria e shprehjes është e rrezikuar në Kosovë, kush mendoni se e rrezikon atë?




Në mënyrë të ngjashme, liria e informacionit në Kosovë është mediokre sipas rezultateve të studimit. Kur janë pyetur se sa e rrezikuar është liria e informacionit në Kosovë, në një shkallë nga 1 në 10, 1 duke qenë "nuk është e rrezikuar fare" dhe 10 duke qenë "krejtësisht e rrezikuar", vlerësimi i të anketuarve del mesatarisht 5,99.

Është e rëndësishme të theksohet se më shumë të anketuar meshkuj, sesa femra, kanë deklaruar se liria e informacionit është e rrezikuar. Në të njëjtin sistem të shkallëzuar³, shifra për të anketuarit meshkuj qëndron në 6,27, ndërsa i njëjti vlerësim qëndron në 5,64 për të intervistuarat femra.

² Respondentët që më parë vlerësonin 5-10 për rrezikimin e lirisë së shprehjes


³ Shkalla nga 1 deri 10, ku 1 = "aspak e rrezikuar" dhe 10 = "plotësisht e rrezikuar".

Figura 32. A mund të na tregoni se sa është rrezikuar liria e informacionit në Kosovë? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak e rrezikuar” dhe 10 = “plotësisht e rrezikuar”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në gjini




Ishte një ndryshim i vogël në mendimin e të anketuarve nga Mitrovica (7,21) dhe Peja (6,25), në krahasim me ata nga Ferizaj (5,15) dhe Gjilan (5,40). Siç nënkuptojnë shifrat, të anketuarit nga Mitrovica dhe Peja ishin më të sigurtë se liria e informacionit ishte e kërcënuar, ndërsa ata nga Ferizaj dhe Gjilani ishin më pak kritik të situatës.

Figura 33. A mund të na tregoni se sa është e rrezikuar liria e informacionit në Kosovë? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak e rrezikuar” dhe 10 = “plotësisht e rrezikuar”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në regjion



Nga të anketuarit që ishin të sigurt se liria e informacionit është e rrezikuar⁴, shumica e tyre kanë perceptimin se ndikimi ka ardhur drejtpërdrejt nga "individë nga politika" (31%), "pronarë të mediave" (17%) dhe "individë nga bizneset" (16%). Vetëm pak të anketuar e shohin "prokurorinë" (5%), "EULEX-in" (4%) ose "policinë" (4%) se kanë ndikim të tillë.


Figura 34. Në rast se besoni se liria e informacionit është e rrezikuar në Kosovë, kush mendoni se e rrezikon atë?



⁴ Respondentët që më parë vlerësonin 5-10 për rrezikimin e lirisë së informacionit


Të anketuarit janë të ndarë në mendim kur është fjala për gazetarët që ndiqen penalisht për shkak të lirisë së shprehjes dhe informacionit. Total 35 për qind besojnë se gazetarët ndiqen penalisht në fakt, 37 për qind besojnë se kjo nuk mund të ndodhë, ndërsa 28 për qind nuk kanë përgjigje.

Figura 35. A ndiqen penalisht gazetarët për shkak të lirisë së shprehjes dhe informacionit?



Të dhënat e anketës tregojnë se të anketuarit besojnë fuqishëm se ka parti politike apo individë të lidhur me parti politike që drejtpërdrejt ose tërthorazi veprojnë në media. Mbi 82 për qind e tyre besojnë kështu për partitë politike, ndërsa 86 për qind e tyre besojnë kështu për individët me lidhje me parti politike.

Figura 36. A ka parti politike apo individë të lidhur me parti politike që në mënyrë direkte apo indirekte drejtojnë mediat e tyre?




Media ka një nivel të drejtë-aksionar të pavarësisë nga pronarët. Rezultatet e anketës tregojnë se në një shkallë nga 1 në 10, me 1 kuptimin "aspak pavarësi" dhe 10 "pavarësi e plotë", vlerësimi mesatar qëndron në 6,02. Me pak fjalë, kjo vlerë do të thotë se të anketuarit besojnë se ka nivele editoriale të pavarësisë nga pronarët e mediave "më lart se mesatarja".

Të anketuarit që pretendonin se ka njëfarë pavarësie editoriale nga pronarët janë pyetur se sa janë censuruar. Përgjigjia më e zakonshme në mesin e gazetarëve ishte se ka një pjesë biznesit, individëve, interesave financiare apo politike që ndikojnë në media. Sipas tyre, ka një pjesë të ndërthurur të interesit mes njerëzve të përfshirë në politikë dhe individëve të cilët drejtojnë biznese, që bëjnë presion ndaj gazetarëve për çështje të veçanta. Analiza e kujdesshme fjalëve të përdorura tregon se fjalët më të zakonshme të përdorura për t'u përgjigjur në këtë pyetje ishin "politikë", "varësi financiar," dhe "ndërhyrje".

Në të njëjtën kohë megjithatë, kur janë pyetur se a ka ndikim nga pronarët e mediave në punën e gazetarëve gjatë aktiviteteve profesionale, në një shkallë nga 1 deri në 10, me 1 duke qenë "aspak" dhe 10 duke qenë "krejtësisht", vlerësimi mesatar ka dalë 5,33. Kjo tregon se ndikimi nga pronarët është i pranishëm në punën profesionale të gazetarëve, me veçanti dhe ndjeshmëri për subjekte.

Në mënyrë të veçantë, të anketuarit që fusha kryesore e veprimit të tyre është politika apo një përzierje e të gjitha temave, priren për të deklaruar se ka më shumë ndikim nga pronarët e mediave gjatë aktiviteteve të tyre profesionale. Respondentët nga fusha e drejtësisë ishin më pak të intriguar për të deklaruar se pronarët e mediave ndikojnë në aktivitetet e tyre profesionale.

Figura 37. A ka ndërhyrje nga ana e pronarëve të mediave në punën e gazetarëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak” dhe 10 = “plotësisht”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në fushën kryesore të veprimit




Nga një perspektivë specifike gjinore, meshkujt ka më shumë gjasa të deklarojnë se kanë më shumë pavarësi nga pronarët - 6,13 - kurse respondentët femra deklarojnë pak më pak - 5,87.

Në mënyrë të ngjashme, redaktori në media ka ndikim të veçantë në punën e gazetarëve gjatë aktiviteteve të tyre profesionale. Vlerësimi mesatar i të njëjtit sistem të shkallëzuar qëndron në 5,71, duke lënë të kuptohet se niveli i ndikimit është më i lartë se mesatarja. Më poshtë janë rezultatet për çdo mesatare të vlerësimit të ndikimit për "pavarësi editoriale nga pronarët", "ndikim të pronarit në punën e gazetarëve" dhe "ndikimin e redaktorit në punën e gazetarëve." Më poshtë janë rezultatet për pavarësinë/ndikimin e redaktorit, pronarit dhe gazetarit.

	Pavarësia editoriale nga pronarët	Ndikimi i pronarëve në punën e gazetarëve	Ndikimi i redaktorëve në punën e gazetarëve
Vlerësimi mesatar nga 1 deri 10, ku 1 = “aspak” dhe 10 = “tërësisht”	6.02	5.33	5.71
Devijimi standard (përhapja)	2.2	2.5	2.4


Grupmoshat më të vjetra janë më shumë të prirë të besojnë se ka ndikim në aktivitetet profesionale të gazetarëve nga redaktorët e mediave sesa grup moshat e reja.

Figura 38. A ka ndërhyrje nga ana e pronarëve të mediave në punën e gazetarëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre? Prej 1 deri 10, ku 1 = “aspak” dhe 10 = “plotësisht”. Tabelimi i kryqëzuar bazuar në grupmosha.



Sipas rezultateve të anketës, pengesat më të mëdha në ushtrimin e profesionit të gazetarisë janë "ndërhyrja nga individë të politikës" (28%), "ndërhyrja nga pronarët e mediave" (17%), "ndërhyrja nga individë të bizneseve" (14%) dhe "ndërhyrja nga qeveria" (14%). Më pak pengues ka dalë të jetë "EULEX-i" dhe "gjykatat", secili me pak më shumë se 3 për qind të përgjigjeve të tëanketuarve.

Figura 39. Nga perspektiva juaj si gazetar, cilat janë pengesat më të mëdha në ushtrimin e profesionit të gazetarisë?




4.6 Siguria në gazetari

Përveç që gazetaria në Kosovë është profesion i vështirë, ne kemi analizuar një sërë temash të tjera të ndërlukuara të tilla si burimi i informacionit të gazetarëve, siguria/mbrojtja fizike, në punë dhe në gjykatë.


Të dhënat e anketës tregojnë se shumica e gazetarëve - 46 për qind - besojnë se burimet e tyre të informacionit me legjislacionin aktual janë të mbrojtura "në një nivel" me vetëm 16 për qind që deklarojnë "krejtësisht" të mbrojtura. Nga ana tjetër, 13 për qind pohojnë se burimet e informacionit të gazetarëve janë "jo tërësisht" të mbrojtura, dhe 25 për qind pohojnë se nuk janë "të mbrojtura aspak."

Figura 40. Sa janë të mbrojtura me legjislacion burimet e informacioneve të gazetarëve?



Hulumtimet e mëtejme kanë zbuluar se masat ligjore në lidhje me mbrojtjen e burimeve të gazetarëve janë ekzekutuar vetëm në "një nivel" - pasi shumica (56%) e të anketuarve kanë pohuar kështu. Vetëm një përqindje e vogël e të anketuarve - 10 për qind - thonë se masa të tilla janë ekzekutuar "plotësisht", ndërsa ata që thonë se nuk janë "ekzekutuar tërësisht" ose "nuk janë zbatuar aspak" janë 6 për qind dhe 18 për qind respektivisht.


Figura 41. Sa zbatohen masat ligjore rreth mbrojtjes së 'burimeve të gazetareve'?



Kushtet e përgjithshme në të cilat gazetarët aktualisht kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme janë konsideruar si nën mesatare. Në një shkallë nga 1 në 10, me 1 duke qenë "shumë e keqe" dhe 10 duke qenë "shumë e mirë", vlerësimi i të anketuarve del 3,94. Kjo shifër plotëson qëndrimin e përgjithshëm kritik mbi çështjet e lidhura me punën e gazetareve të raportuara në studim.


Duke analizuar informatat nga një pikëvështrim etnik, lidhur me kushtet e përgjithshme në të cilat gazetarët kryejnë punën e tyre të përditshme, shqiptarët e Kosovës përgjithësisht e vlerësojnë situatën si të keqe (4,42), në krahasim me serbët e Kosovës të cilët kanë një mendim mjaft pozitiv (1,42).

Figura 42. Personalisht, si do ti vlerësonit kushtet përgjithshme në të cilat punojnë gazetarët? Vlerëso prej 1 deri 10, ku 1 është "shumë keq" dhe 10 është "shumë mirë" Tabelimi i kryqëzuar bazuar në etnicitet.




Sa për sigurinë fizike të gazetarëve gjatë punës së tyre të përditshme, mbi 62 për qind e të anketuarve pohojnë se ata janë të kërcënuar me dhunë "deri në një nivel" dhe 22 për qind thonë se ata janë "plotësisht" të kërcënuar. Këto shifra tregojnë se gazetaria është një profesion mjaft i rrezikshëm për të ushtruar në këtë kohë.

Figura 43. Sipas jush, a janë gazetarët të kërcënuar nga dhuna fizike gjatë ushtrimit të detyrës së tyre?




Në pyetjen nëse policia ofron mbrojtjen e nevojshme për gazetarët, 14 për qind pohojnë se ajo është ofruar "plotësisht", 56 për qind e të anketuarve pohojnë se ajo është ofruar "deri në një nivel", 19 për qind pohojnë "jo krejtësisht" dhe vetëm 11 për qind pohojnë se ajo nuk është "ofruar aspak".

Figura 44. A u ofrohet mbrojtja gazetarëve nga policia në rastet kur kërkohet?




Institucionet e drejtësisë në përgjithësi trajtojnë rastet e krimit të gazetarëve në mënyrë adekuate (në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë). Shumica e të intervistuarve pohuan se rastet e krimit janë ose trajtohen "plotësisht" (7%) në mënyrë adekuate, ose "deri në një nivel" (46%). Nga ana tjetër, përqindja e të anketuarve që besojnë se rastet e krimit janë trajtuar "jo tërësisht" siç duhet është 27 për qind, ndërsa përqindja e atyre që besojnë se këto raste nuk janë trajtuar absolutisht në mënyrë adekuate është 20 për qind.

Figura 45. A i trajtojnë institucionet e drejtësisë rastet e krimit të gazetarëve në mënyrë adekuate (të duhur dhe të shpejtë)?




Sipas të anketuarve, shumica e të anketuarve nuk kanë kontrata të rregullta të punësimit. Kur janë pyetur nëse gazetarët në Kosovë kanë kontrata të rregullta të punësimit, një total prej 45 për qind kanë deklaruar "jo", 33 për qind "po" dhe 22 për qind nuk kanë informata.

Figura 46. Sipas jush, a kanë gazetarët kontrata të rregullta të punës?



Nga ata që thonëse gazetarët kanë kontrata të rregullta të punës, shumica e tyre (62%) kanë deklaruar se këto kontrata zbatohen praktikisht "deri në një nivel," dhe vetëm pak prej tyre (16%) besojnë se ato janë zbatuar "plotësisht". Figura e mëposhtme tregon nivelet e pasigurisë të përhapur në mesin e të anketuarve me mendime të ndryshme nga zbatimi i plotë dhe poshtë te ata që besojnë se nuk ka absolutisht asnjë zbatim praktik të kontratave të punës.

Figura 47. Nëse po, a zbatohen këto kontrata?



Kur kemi pyetur të anketuarit se sa ofrojnë qëndrueshmëri financiare kontratat e punës, në një shkallë nga 1 deri në 10, me 1 duke qenë "aspak" dhe 10 "plotësisht", vlera mesatare ka dalë 5,77. Ky rezultat tregon se njëfarë qëndrueshmërie financiare është e siguruar edhe pse jo në nivel të kënaqshëm - pak më e dobishme për ata që e shohin atë si më afër me "plotësisht" e kënaqshme.

Ka një ndryshim të vogël në opinionin ndërmjet të anketuarve meshkuj dhe femra - meshkujt e anketuar e vlerësojnë qëndrueshmërinë financiare të këtyre kontratave në 5,55, ndërsa femrate vlerësojnë atë në 6,09.

5. Përmbyllje

Liria e shprehjes dhe informacionit njihet nga shumica e gazetarëve të intervistuar, edhe pse njohuritë më të detajuara i kanë të kufizuara. Ata nuk janë në dijeni të pikëpamjes ligjore dhe zbatueshmërisë së lirisë së medias, të garantuar me Kushtetutën e Kosovës. Shpesh, liria e të shprehurit dhe informacionit keqinterpretohet dhe bie pre e ndikimit politik.

Gazetarët s'janë krejt në dijeni të censurës shtetërore mbi mediat, pasi dyzet e nëntë për qind e tyre thonë se nuk kanë informacion për këtë temë. Besimi i përgjithshëm është se shteti nuk përqendrohet kryesisht në censurimin e medias, ndonëse gazetarët shfaqin shqetësim. Sipas tyre, liria e shprehjes është "e rrezikuar" deri në një nivel shqetësues.

Burimet e informacionit mbrohen gjerësisht, ndërsa masat ligjore për mbrojtjen e gazetarëve nuk zbatohen në nivele të dëshirueshme. Gazetarët herë pas here kërcënohen gjatë aktiviteteve të tyre profesionale me dhunë fizike, porse pohojnë se mbrojtja policore është dukshëm e efektshme për trajtimin e çështjeve të tilla.

Mekanizmat (vetë)rregullues, pra Komisioni i Pavarur për Media dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, funksionojë me efektshmëri dhe pa njëanshmëri. Prodhimi i tyre kundrohet me kujdes dhe seriozitet nga të gjitha institucionet. Gazetarët, kur u sigurohet liria, u treguan të zellshëm t'i raportonin rezultatet pozitive kur përfshihen këta mekanizma. Institucionet më miqësore ndaj mediave janë policia dhe komunat, ndërsa EULEX-i perceptohet si më së paku miqësor.

Kur është fjala te njëanshmëria e mediave, afro gjysma e të anketuarve besojnë se ka media të paanshme në Kosovë, ndërsa tridhjetë e tetë për qind besojnë se nuk ka media të paanshme. Ky dallim në opinion tregon se mediat veprojnë në mënyra të ndryshme. Ngjashëm, kishte pohime lidhur me transmetuesin publik të Kosovës, ku shumica e të anketuarve mendonin se ishte i ndikuar politikisht.

Në thelb, profesioni i gazetarëve është e vështirë të ushtrohet në Kosovë, duke pasur parasysh problemet me kontrata pune, ndikimin e drejtpërdrejtë editorial nga pronarët dhe individët e përfshirë politikisht, kufizimet në lirinë e shprehjes dhe nivelet shqetësuese të censurës shtetërore.

Aneksi. Pyetësi i hulumtimit

Përhëndetje, unë quhem _____ dhe punoj për agjencionin UBO Consulting. Me kërkesën e organizatave Kosovo Global (Kosovo 2.0), Çohu dhe Këshillit të Mediave të Shkruara, ne jemi duke bërë një hulumtim sasior për të parë perceptimet e gazetarëve në Kosovë mbi lirinë e mediave, bazuar në 27 indikator të Këshillit të Evropës. Ne do të vlerësonim shumë kontributin tuaj nëse do të ndanit disa minuta të kohës tuaj për të mbushur këtë pyetësor. Informatat personale të përdorura për qëllimet të këtij pyetësi janë konfidenciale dhe përdoren vetëm për nevojat e këtij hulumtimi.

1. Sipas jush, a garantohet liria e **shprehjes** me legjislacionin (Kushtetutën) e Kosovës?

1. Po [**Kalo në pyetjen 2**]
2. Deri në një masë po
3. Deri në një masë jo
4. Jo
5. Nuk e di [**Kalo në pyetjen 2**]

1.1 Në rast të përgjigjes **në pyetjen paraprake me 2, 3 ose 4**, a mund të na thoni arsyet: [**Përgjigje e shumëfishtë**]

1. Mungesa e legjislacionit të drejtpërdrejtë (për lirinë e shprehjes dhe informacionit);
2. Legjislacioni i mangët;
3. Zbatimi jo i duhur nga organet përgjegjëse;
4. Zbatim jo i duhur nga organet e drejtësisë;
5. Tjetër _____

2. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së **shprehjes**? [**Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht**]

Aspak 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 **Plotësisht**

2.1 Në rast të përgjigjes **në pyetjen paraprake nga 1 deri në 5**: Kush e pengon më shumë ushtrimin e lirisë së shprehjes? [**Përgjigje e shumëfishtë**] [**Mos lexo opsionet**]

1. Ndërhyrja nga Qeveria;
2. Ndërhyrja nga Prokuroria;
3. Ndërhyrja nga Policia;
4. Ndërhyrja nga Gjykatat
5. Ndërhyrja nga EULEX-i;
6. Ndërhyrja nga individët nga politika;
7. Ndërhyrja nga individët nga biznesi;
8. Ndërhyrja nga pronarët e mediave;
9. Ndërhyrja nga redaktorët përgjegjës;
10. Vetë-censura
11. Mungesa e vet-qëndrueshmërisë financiare

12. Ndërhyrjet ndërkombëtare

13. Tjetër _____

3. Sipas jush, a garantohet liria e informacionit me legjislacionin (Kushtetutën) e Kosovës?

1. Po [**Kalo në pyetjen 4**]
2. Deri në një masë po
3. Deri në një masë jo
4. Jo
5. Nuk e di [**Kalo në pyetjen 4**]

3.1 Në rast të përgjigjes **në pyetjen paraprake me 2, 3 ose 4**, a mund të na thoni arsyet: [**Përgjigje e shumëfishtë**]

1. Mungesa e legjislacionit të drejtpërdrejtë (për lirinë e shprehjes dhe informacionit);
2. Legjislacioni i mangët;
3. Zbatimi jo i duhur nga organet përgjegjëse;
4. Zbatim jo i duhur nga organet e drejtësisë;
5. Tjetër _____

4. Sa janë duke u zbatuar garancitë ligjore për sa i përket lirisë së informacionit? [**Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht**]

Aspak 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 **Plotësisht**

4.1 Në rast të përgjigjes nga **1 deri në 5**: Kush e pengon më shumë zbatimin e lirisë së informacionit? [**Përgjigje e shumëfishtë**]

1. Ndërhyrja nga Qeveria;
2. Ndërhyrja nga Prokuroria;
3. Ndërhyrja nga Policia;
4. Ndërhyrja nga Gjykatat
5. Ndërhyrja nga EULEX-i;
6. Ndërhyrja nga individët nga politika;
7. Ndërhyrja nga individët nga biznesi;
8. Ndërhyrja nga pronarët e mediave;
9. Ndërhyrja nga redaktorët përgjegjës;
10. Vetë-censura
11. Mungesa e vet-qëndrueshmërisë financiare;
12. Ndërhyrjet ndërkombëtare;
13. Tjetër _____

5. A lejon legjislacioni i Kosovës, në ndonjë rast, censurën nga shteti?

1. Po
2. Jo [**Kalo në pyetjen 6**]
3. Nuk e di [**Kalo në pyetjen 6**]

5.1 Në rast se Po, në cilin rast dhe kur?

- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____

6. Sipas jush, sa mundohen autoritetet shtetërore të censurojnë mediat? ? [Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht]

Aspak 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 Plotësisht

6.1 Në rast të përgjigjes nga 5 deri 10, atëherë si ndodhë/bëhet kjo?

- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____

7. Ju lutem a mund të na tregoni se sa është e rrezikuar liria e shprehjes në Kosovë? [Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak e rrezikuar dhe 10 plotësisht e rrezikuar]

Aspakerrezikuar 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 Plotësisht e rrezikuar

7.1 Në rast të përgjigjes nga 5 deri në 10, nga kush është e rrezikuar liria e shprehjes në Kosovë? [Përgjigje e shumëfishtë]

- 1. Qeveria;
- 2. Prokuroria;
- 3. Policia;
- 4. Gjykatat
- 5. EULEX-i;
- 6. Individët nga politika;
- 7. Individët nga biznesi;
- 8. Pronarët e mediave;
- 9. Redaktorët përgjegjës;
- 10. Tjetër _____

8. Ju lutem a mund të na tregoni se sa është e rrezikuar liria informacionit në Kosovë? **[Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak e rrezikuar dhe 10 plotësisht e rrezikuar]**

Aspakerrezikuar 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 **Plotësisht e rrezikuar**

- 8.1 Në rast të përgjigjes nga **5 deri në 10**, nga kush është e rrezikuar liria e informacionit në Kosovë? **[Përgjigje e shumëfishtë]**

1. Qeveria;
2. Prokuroria;
3. Policia;
4. Gjykatat
5. EULEX-i;
6. Individët nga politika;
7. Individët nga biznesi;
8. Pronarët e mediave;
9. Redaktorët përgjegjës;
10. Tjetër _____

9. A ndiqen penalisht gazetarët për shkak të lirisë së shprehjes dhe informacionit?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

10. A funksionojnë mekanizmat rregullues të mediave (KPM dhe KMSHK) në mënyrë të paanshme dhe efektive?

(Komisioni i Pavarur për Mediave)

(Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës)

1. Po, plotësisht
2. Deri në një masë po
3. Deri në një masë jo
4. Jo, aspak
5. Nuk e di

1. Po, plotësisht
2. Deri në një masë po
3. Deri në një masë jo
4. Jo, aspak
5. Nuk e di

11. A merren parasysh vendimet e trupave (vetë)rregullues (KPM-së dhe KMSHK-së) nga organet e drejtësisë?

(Vendimet e KPM-së)

(Vendimet e KMSHK-së)

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

12. Sa janë të hapura institucionet e mëposhtme për mediat? [Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak të hapura dhe 10 plotësisht të hapura]

Nr.	Emërtimi i institucioneve	Vlerëso nga 1 deri 10 për secilën
1.	Qeveria e Kosovës	
2.	Kuvendi i Kosovës	
3.	Presidenca	
4.	Gjyqësori	
5.	Policia	
6.	EULEX-i	
7.	Prokuroria	
8.	Agjencitë e Pavarura	
9.	Ndërmarrjet publike	
10.	Komunat	
11.	Partitë Politike	
12.	Tjetër (specifiko) _____	

13. A janë të hapura në mënyrë të njëjtë dhe të drejtë institucionet e mëposhtme për të gjitha mediat:

	PO	JO
a) Qeveria e Kosovës	1	2
b) Kuvendi i Kosovës	1	2
c) Presidenca	1	2
d) Gjyqësori	1	2
e) Policia	1	2
f) EULEX-i	1	2
g) Prokuroria	1	2
h) Agjencitë e Pavarura	1	2
i) Ndërmarrjet publike	1	2
j) Komunat	1	2
k) Partitë Politike	1	2
l) Tjetër _____	1	2

14. A ka parti politike **apo individë të lidhur me parti politike** që në mënyrë direkte apo indirekte drejtojnë mediat e tyre?

	PO	Jo
a) Parti politike	1	2
b) Individë të lidhur me parti politike	1	2

15. A ka media politikisht të paanshme nga aspekti i politikave redaktuese?

1. Po
2. Jo [kalo në pyetjen 16]
3. Nuk e di [kalo në pyetjen 16]

15.1 Nëse Po, sa është numri i atyre te pavarura?

1. Të gjitha
2. Shumica, jo të gjitha
3. Gjysma
4. Një numër i vogël
5. Nuk mund ta përcaktoj

16. Në aspektin e politikave redaktuese dhe funksionimit të përditshëm, a është transmetuesi publik (RTK-ja) i pavarur nga ndërhyrjet politike?

1. Po, plotësisht
2. Deri në një masë po
3. Deri në një masë jo
4. Jo, aspak
5. Nuk e di

17. A kanë mediat kod të etikës?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

17.1 Në rast të përgjigjes **Po**: Sa zbatohet ky kod? **[Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht]**

Aspak 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 **Plotësisht**

18. Në çfarë mase gazetarët e informojnë publikun e tyre për ndonjë interes, politik, financiar apo të ndonjë interes tjetër që ata mund të kenë nga bashkëpunimi me institucionet e shtetit? **[Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht]**

Aspak 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 **Plotësisht**

19. Sipas jush, a kanë gazetarët kontrata të rregullta të punës?

1. Po
2. Jo **[Kalo në pyetjen 20]**
3. Nuk e di **[Kalo në pyetjen 20]**

19.1. Nëse Po, a zbatohen këto kontrata?

1. Po, plotësisht
2. Deri në një masë po
3. Deri në një masë jo
4. Jo, aspak

5. Nuk e di

- 19.2. Sa ofrojnë qëndrueshmëri financiare këto kontrata? **[Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht]**

Aspak 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 **Plotësisht**

20. Në çfarë mase mediat kanë pavarësi redaktuese nga pronarët? **[Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht]**

Aspak 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 **Plotësisht**

- 20.1 Në rast të përgjigjes nga **1 deri në 5**, cilat janë mënyrat e cenimit të pavarësisë redaktuese?

a) _____

b) _____

c) _____

21. A ka ndërhyrje nga ana e pronarëve të mediave në punën e gazetarëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre? **[Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht]**

Aspak 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 **Plotësisht**

22. A ka ndërhyrje në punën e gazetarëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre nga redaktorët e mediave? **[Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht]**

Aspak 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 **Plotësisht**

23. Nga perspektiva juaj si gazetar, cilat janë pengesat më të mëdha në ushtrimin e profesionit të gazetarisë? **[Përgjigje e shumëfishtë]**

1. Ndërhyrja nga Qeveria;
2. Ndërhyrja nga Prokuroria;
3. Ndërhyrja nga Policia;
4. Ndërhyrja nga Gjykatat
5. Ndërhyrja nga EULEX-i;
6. Ndërhyrja nga individët nga politika;
7. Ndërhyrja nga individët nga biznesi;
8. Ndërhyrja nga pronarët e mediave;
9. Ndërhyrja nga redaktorët përgjegjës;
10. Tjetër _____

24. Sa janë të mbrojtura me legjislacion burimet e informacioneve të gazetarëve’?
1. Plotësisht
 2. Deri në një masë po
 3. Deri në një masë jo
 4. Aspak **[Kalo në pyetjen 25]**
 5. Nuk e di
- 24.1 Sa zbatohen masat ligjore rreth mbrojtjes së ‘burimeve të gazetarëve’?
1. Plotësisht
 2. Deri në një masë po
 3. Deri në një masë jo
 4. Aspak
 5. Nuk e di
25. Personalisht, si do ti vlerësonit kushtet e përgjithshme në të cilat punojnë gazetarët? **[Juletëm vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak të mira dhe 10 Shumë të mira]**
- | | | | | | | | | | | | |
|----------------------|---|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----------------------|
| Aspak të mira | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | Shumë të mira |
|----------------------|---|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----------------------|
26. Sipas jush, a janë gazetarët të kërcënuar nga dhuna fizike gjatë ushtrimit të detyrës së tyre?
1. Plotësisht
 2. Deri në një masë po
 3. Deri në një masë jo
 4. Aspak
 5. Nuk e di
27. A u ofrohet mbrojtja gazetarëve nga policia në rastet kur kërkohet?
1. Plotësisht
 2. Deri në një masë po
 3. Deri në një masë jo
 4. Aspak
 5. Nuk e di
28. A i trajtojnë institucionet e drejtësisë rastet e kërcënimit të gazetarëve në mënyrë adekuate (të duhur dhe të shpejtë)?
1. Plotësisht
 2. Deri në një masë po
 3. Deri në një masë jo
 4. Aspak
 5. Nuk e di

29. Personalisht, si e vlerësoni nivelin e profesionalizmit të gazetarëve në mediat kosovare? [Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë shumë dobët dhe 10 shkëlqyeshëm]

Shumë dobët 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 Shkëlqyeshëm

30. Sa mendoni se publiku u beson mediave? [Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë aspak dhe 10 plotësisht]

Aspak 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 Plotësisht

31. Si e vlerësoni nivelin e përgjithshëm të profesionalizmit të mediave të mëposhtme? [Ju lutem vlerësoni nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë shumë dobët dhe 10 shkëlqyeshëm]

Nr.	Lloji i medias	Vlerëso nga 1 deri në 10 për secilën media
1	TV	
2	Radio	
3	Gazeta	
4	Portale	

TË DHËNAT DEMOGRAFIKE:

D1. Mosha (sa vjeç jeni): |__|__|

D2. Gjinia:

1. Mashkull
2. Femër

D3. Shkollimi i përfunduar

1. Shkolla e mesme
2. Fakulteti
3. Magjistratura/studimet master
4. Doktorata
5. Tjetër _____

D3. Fusha e shkollimit

1. Ekonomi
2. Juridik
3. Gazetari
4. Shkenca Politike
5. Gjuhe dhe letërsi
6. Histori
7. Tjetër _____

D4. Lloji i mediumit ku punoni

1. TV
2. Radio
3. Gazetë
4. Portal

D5. Cila është fusha kryesore e punës tuaj?

1. Ekonomia
2. Politika
3. Çështjet sociale
4. Kultura
5. Sporti
6. Tjetër _____

D6. (PËRKATËSIA ETNIKE) Cili është nacionaliteti Juaj/cilit grup i takoni?

1. Shqiptarë
2. Serbë
3. Boshnjak
4. Goran
5. Turk
6. Rom
7. Ashkali
8. Egjiptas
9. Tjetër. Cili? _____
10. Refuzon

D7. REGJIONI [Kodet: 1- Prishtina, 2-Mitrovica, 3-Prizreni, 4-Peja, 5-Ferizaj, 6-Gjakova, 7-Gjilani]

|_|_|

D8. KOMUNA _____